Shtojca Nr. 3: Pyetësori për Institucionin Publik të Qeverisjes Qendrore

V. PROKURIMET PUBLIKE

54. A jeni i/e përfshirë në proceset e prokurimit publik në institucionin tuaj *(si anëtar i komisionit të vlerësimit, person përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike, ose në çdo rol tjetër)*?

- Po, drejtpërdrejtë (jam anëtar/e komisioni ose person përgjegjës)
- Po, tërthorazi (mbështes procesin pa qenë anëtar apo person përgjegjës)
- Jo, nuk kam asnjë lidhje me proceset e prokurimit publik
- Nuk e di nëse detyrat e mia lidhen me prokurimin publik

55. Sa të njohur jeni me legjislacionin dhe rregullat që rregullojnë prokurimet publike *(p.sh., Ligji për prokurimin publik, aktet nënligjore, udhëzimet e APP-së)*?

- Aspak
- Pak
- Plotësisht

56. Sipas Ligjit nr.162/2020, autoriteti kontraktor ka detyrimin të caktojë një person përgjegjës për prokurimin. A jeni në dijeni nëse institucioni juaj e ka përmbushur këtë detyrim ligjor?

- Po, institucioni ka një person përgjegjës të caktuar zyrtarisht;
- Po, institucioni ka person përgjegjës, por roli i tij nuk është i qartë për punonjësit;
- Jo, nuk jam në dijeni të ekzistencës së personit përgjegjës;
- Nuk e di

57. Gjatë 2 – 3 viteve të fundit, a keni dëgjuar ose keni qenë dëshmitar i ndonjë situate ku specifikimet teknike të një tenderi të jenë hartuar në mënyrë të tillë që të kenë favorizuar një operator të caktuar?

- Po, kam dëgjuar, por nuk kam qenë dëshmitar;
- Po, kam dëgjuar dhe kam qenë dëshmitar;
- Jo, nuk kam dëgjuar dhe as nuk kam qenë dëshmitar;
- Nuk e di

58. Gjatë 2 -3 viteve të fundit, a keni dëgjuar për ndonjë rast ku një person i përfshirë në procesin e prokurimit publik ka pasur konflikt interesi *(p.sh., lidhje familjare, interesa financiare ose marrëdhënie të tjera me ofertuesit)* dhe nuk e ka deklaruar apo nuk është tërhequr nga procesi?

- Po, kam dëgjuar për raste të tilla;
- Jo, nuk kam dëgjuar për ndonjë rast konkret;
- Nuk e di

59. Sa të qarta, të kuptueshme dhe specifike janë rregullat mbi konfliktin e interesit në fushën e prokurimeve publike *(formular i deklarimit të konflikti të interesit, detyrimi për deklarim, heqja dorë, etj)*?

- Shumë të qarta, të kuptueshme dhe specifike;
- Aspak të qarta, të kuptueshme apo specifike;
- Nuk e di

60. Gjatë 2 -3 viteve të fundit, a janë konstatuar dhe dokumentuar raste të konfliktit të interesave në fushën e prokurimeve publike në institucionin ku ju punoni?

- Po, janë konstatuar dhe dokumentuar;
- Po, janë konstatuar, por jo dokumentuar;
- Jo, nuk janë konstatuar dhe as dokumentuar;
- Nuk kam akses në këtë informacion;
- Nuk e di

61. A jeni trajnuar ndonjëherë nga institucioni juaj mbi etikën dhe integritetin në fushën e prokurimeve publike?

- Po, jam trajnuar mënyrë periodike;
- Jam trajnuar, por jo në mënyrë sistematike;
- Jo, nuk kam trajnuar asnjëherë;
- Nuk e di.

62. Nëse do të donit të raportoni/sinjalizoni një parregullsi apo shkelje që lidhet me prokurimet publike, a dini ku dhe si ta raportoni/sinjalizoni?

- Po, e di (specifiko strukturën përkatëse_____)
- E di përafërsisht, por jo me saktësi;
- Nuk e di

63. A mendoni se proceset e prokurimit publik në institucionin tuaj janë transparente dhe lehtësisht të monitorueshme nga publiku ose palët e interesuara? ***(p.sh. publikimi i njoftimeve, vendimeve, kontratave në regjistrin e prokurimeve, etj)***

- Po, janë transparente dhe të monitorueshme;
- Jo, nuk janë transparente dhe as të monitorueshme;
- Disi transparente dhe të monitorueshme;
- Nuk e di

64. Ligji për prokurimet publike parashikon të drejtën e operatorëve ekonomikë për të ankimuar vendimet e autoritetit kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik (KPP). A mendoni se ky mekanizëm ankimimi është efektiv dhe i njohur mjaftueshëm nga punonjësit dhe operatorët?

- Po, mekanizmi i ankimimit është efektiv dhe i njohur mirë;
- Mekanizmi i ankimimit ekziston, por nuk është efektiv dhe i njohur mirë;
- Nuk jam në dijeni të këtij mekanizmi;
- Nuk e di